



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË

Nr. 3816 prot.

Himarë, më 20.05.2025

**THIRRJE PUBLIKE PËR PJESËMARRJEN E TË RINJVE NË PROGRAMIN E  
NXITJES SË PUNËSIMIT TË BIZNESIT RINOR**

Bashkia Himarë shpall thirrjen publike për aplikimin në projektin për fondin e programit të nxitjes së punësimit të biznesit rinor, i cili financohet me vlerën totale prej 10,000,000 lekësh nga Bashkia Himarë. Ky program është pjesë e mbështetjes dhe nxitjes ekonomike, ku të rintjtë kanë mundësinë të aplikojnë për grante për projekte biznesi individuale, të krijuara për të mbështetur hapjen ose zgjerimin e aktiviteteve të tyre të biznesit. Qëllimi i projektit është të mbështesë plane të qëndrueshme biznesi të krijuara nga të rintjtë në Himarë, duke i ndihmuar ata të përballojnë sfidat e tregut konkurruar. Procesi i përzgjedhjes do të sigurojë transparencë dhe mundësi të barabarta për të gjithë aplikantët, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së investimeve dhe ndikimin pozitiv në zhvillimin ekonomik të komunitetit.

Përveç mbështetjes me fonde, programi do të ofrojë gjithashtu trajnim dhe këshillim për të rintjtë që synojnë të zhvillojnë ose të përmirësojnë aftësitë e tyre në fushën e sipërmarrjes. Programi do të zbatohet në të gjithë territorin e Bashkisë Himarë dhe do të ketë kuota të përcaktuara për financimin e bizneseve të reja dhe atyre ekzistuese sipas modelit 50/50. Të gjithë të interesuarit ftohen të aplikojnë brenda datës **20.07.2025** në thirrjen zyrtare duke iu përmbajtur kriterieve në udhëzuesin e publikuar në linkun si mëposhtë:

<https://himara.gov.al/udhezues-operacional-per-zbatimin-e-projektit-progrmi-i-nxitjes-se-punesimit-te-biznesit-rinor/>.

KRYETARI I BASHKISE

Vangjel Tavo

